


ZHULIANA G. JORGANXHI

8SH-1

J 76

Net  
provimesh



VJERSHA

*8SH-1*

*7 26*

*S*

BIBLIOTEKA E RINISE

ZHULJANA G. JORGANXHI

# NET PROVIMESH

(Vjershë)

*51248*

*BIBLIOTEKA E SHTETIT  
GUROKASIT*

*N 743*

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Piktor: SPIRO KRISTO

Tirazhi 3 000 kopje      Format 70 x 100/32      Stash: 2204-65

---

Shtyp NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI» —  
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1969

## KUR LINDA UNË...

Kur linda unë, vajz' e dytë,  
gjyshja ja qau hallin nënës sime,  
psherëtiu, duke fshirë sytë,  
«Eh, — tha, — vajza ka aq halle e shqetësime».

Por unë s'e njoha atë jetë.  
Këngë me fjalë krejt të reja  
kur linda unë, nëna më këndonte.  
Në to bukur shpërthente gazi dhe hareja.

Sa herë eca e shkujdesur  
rrugëve të qytetit tim,  
me një fustan basme veshur:  
prodhim i parë kombinatit tekstil.

E shihja tim atë, nganjëherë,  
të lodhur nga puna e ditës,  
se kish nevojë Shqipëria nënë  
për bukë,

për veshje,  
për dritë!

Dritë!

Që mbi ty, atdhe, mos të rëndonte  
padija, si natë e zezë,  
Që vajza te burri mos të shkonte,  
si plaçkë në treg e blerë...


Mbi gjoksin e shtrenjtë të atdheut  
mbështeta dhe unë dorën time;  
ndjeva si buçiste dheu,  
nga këngët,

marshet  
dhe gëzimet!

• • • • • , • • , , ,  
E kësaj toke jam filiz i ri  
dhe rrënjet i kam ngulur mirë.  
Më rriti dora jote, o Parti,

mes ajrit të pastër,  
në tokën e lirë!

Dhe dua unë me shokët të punoj,  
Që nesër mos më quajnë «delikate».  
Në kohën tonë duhet të krijosh  
dhe vjersha,  
dhe këngë,  
dhe pallate! . .



## MOSHATAREVE

Erdhëm ne në botë...  
Rroben gjith' arna paragjykimesh flakëm tej,  
Dashurinë s'do ta gjejmë të myllur në një  
strokë,  
ku pëlhirën e saj merimanga të endë.

Me shokun e jetës s'do na njohë trishtimi,  
por puna e madhe, vrulli, hovi  
se ne kemi lindur nën tinguj marshimi  
dhe nën këta tinguj do ecim gjithmonë.

Jeta s'është për ne roman dashurie,  
që nën hije pemësh mundet ta lexojmë.  
Ajo është për ne një port i madh anijesh  
ku ëndërra,  
punë,  
djersë,  
çdo ditë,  
shkarkojmë!

## NÈ MARSHIM

Me yje gjoksin ka stolisur nata,  
na fton t  ecim rrug s papushim.  
Mbi trupn' e tok s hidhen  
mij ra hapa,  
rinia niset sonte n  marshim.

Me yje gjoksin ka stolisur nata,  
na fton t  ecim rrug s papushim.

Rinia ime s'di t'i ndali hapat;  
me këngë në gojë ajo pret  
çdo marshim.

**1967**



## RRESHTOHUNI, MOTRA!

Pushkën mbi sup dhe unë e hodha,  
gjëmimi i topit s'më tremb aspak.  
Shkoj në sulm barkas.

Ngrihem,  
qëlloj,  
ushtarja jote, atdhe, sot jam.

Kur krisma pushkësh u dëgjuan në malet tonë,  
në një rresht me burrat luftuan dhe gratë.  
Kaloi kjo pushkë në supet e njoma  
dhe erdhi tek unë si një stafetë e gjatë.

1968

## TI

Ty s'të foli babaj atë natë,  
veç vështrimin rreptë në sy ta treti,  
nuk e priste që ti, vajz' e parë,  
me guximin tënd të dëboje mblesin.

Ti urren mblesët mätrapazë,  
fjalët e tyre — kënetë,  
ku të buk'rat ëndrra s'mbijnë dot,  
ndaj e ngrite grushtin me të shpejtë,  
që nga gaz' i mblesit  
mos të gëlltisje lot.

Qershori 1968



## NE DHE NATA

Ne natës ja thyem qetësinë  
me zhurmë maqinash e traktorësh,  
Në rrëmbat e saj shtimë  
djersë kantjeresh,  
këngë punëtorësh.

1968



## GJITHMONË ME NE

Në xhep thirrja ushtarake,  
në dorë librat dhe një tranzistor.  
Radio Tirana lajmet jepte:  
«Shqipëria në festë. Nëntor.»

Po ç'ka sot qelli që shtrydh kaq shi  
dhe vetëtima shkaravit parreshtur?  
Mendon mësuesi: «Nxënësit tani,  
të gjithë në shkollë janë mbledhur.»

Humner' e thellë në gji të saj  
desh të rrëmbejë të tillë hero,  
por flamuri i tij u ngrit më lart  
mijëra të tjerë e morën në dorë.

**dhjetor 1968**


## NË STËRVITJE

E dinim ne, kështu do të takoheshim  
të dy të veshur si ushtarë  
Ti, buzëqesh, kur unë rreshtohem  
e mund të jap, si ti, komandë.

Mbi supet tona, ende fëmijë,  
një pushkë druri mbajtëm të dy.  
A e mban mend rrugicën tonë?  
Sa herë së bashku lojtëm aty . . .

Mbi kokat tona dielli nxeh,  
po nga stërvitja asnë s'largohet.  
T'i shoh unë djersët e ti m'i sheh  
Krahu pas pushkës më shumë shtërngohet.

Kështu do ecim ne të dy  
Krah njëri-tjetrit gjithëmonë.



## NET PROVIMESH

Gjumin sonte dua ta largoj,  
Veç qepallat mbi libër ulen rëndë.  
Papritur . . .

melodinë e dashur dëgjoj  
dhe ja, ti hyn  
së bashku me atë këngë.

1968

LIBRIKA E SHTRU  
GEROMASHP

17

STR48  
12743

## NJË SHOQEJE

Ajo erdhi vonë atë natë.  
Në dhomë asnjë s'e qortoi.  
E dinim . . .  
Ajo ishte ndarë,  
të dlirtatëndërra  
s'do ja trembte zakonit.

1968

## **NA PRIT ME GAZ, MYZEQE!**

U nis maqina . . .

«Pra, mirupafshim!»

Motër e dashur më përshëndet.

Ah, këtë çast, sa e kam dashur! . . .

Na prit me gaz,

o Myzeqe!

**1967**

# ESHTÈ SINFONIA JOTE, MOJ RINI!

Si pentagramë do të zgjaten këtu  
shinat  
dhe do të shkruhet një tjetër  
sinfoni,  
sinfoni e ditëve të mia,  
sinfonia jote,  
moj rini!

## S O N T E . . .

Ti sonte herët re në shtrat,  
qerpikët e shqetësuar do t'i mbyllësh.  
Mendon e heshtur për çdo çast  
dhe nervat t'i ngacmon çdo zhurmë.

Sonte . . .

«Të dua!», ai të tha.  
Sa shumë atë çast shkëlqyen sytë,  
por ishte natë,  
                      ai nuk pa  
si vend në ta ndjenjat zunë.

Vërtitesh ti sonte në shtrat,  
mendimet të vërshojnë si lumë.  
Dashuria erdhi dhe me vrap  
ty të rrëmbeu një natë pa gjumë.

## LETËR VËLLAIT

U nise, vëllaçko, për në fshat,  
briskun fajes ende s'ja ke shkuar.  
Nëna shpesh për ty bëhet merak  
kur vonon letër për të shkruar.

Ka merak flokargjënda nënë.  
Larg saj jetën do të fillosh,  
je i ri, ndaj shpesh ajo trishtohet...  
Fshat më fshat me vdekjen do luftosh.

Ndihmës-mjek i ri! Do të çohesh  
në mesnatë, nëpër borë e shi,  
gjumi shpejt prej sysh do të largohet  
gjithnjë pranë njerzve do ndodhesh ti.

Ndoshta kömböt dhe do të të vriten,  
shiun do durosh mbi supet ti.


Ty malsorja, si një nënë e mirë,  
do të presë me gaz e dashuri.

Dikur, të vjen ndërmënd? — nënës i ke thënë:  
«Kur të rritem, unë do të bëhem mjek».  
Ishte nat' e bukur, gjithë yj' e hënë...  
Qeshi nëna. Flokët t'i lëmoi lehtë.

Eh, çapkën i vogël, mëhallës fishkëlleje,  
ndonjëherë plakat të qortonin ty,  
se fishkëlleje gjithmonë në mbrëmje,  
kur qytet i lindjes binte në qetësi.

Të priste nëna «doktor» në qytet,  
po ti në malsi shkove vullnetar,  
ndaj i the nënës: Eja më përcill!  
dhe pa lot uro: «Bir, udhë të mbarë!»

1967



## RRUGICA IME

Tek ti i hodha të parat hapa,  
o rrugic' e dashur me kalldrëm mbuluar!  
Sa shpejt rrodhën vitet...  
Rininë tani kapa,  
kurse ti gjithmonë,  
si fëmijëria jonë,  
me zhurmë gazmore mbete e ngarkuar...

1966

## MOSHATARES REPUBLIKË

Sot mbushim 19 vjet.

Të dyja kemi lindur në një ditë  
dhe u përkundëm nga një dorë,  
moj moshatarja ime,

Republikë!

U rrite Ti...

Dhe unë s'mbeta pas.

Dhe buzëqesh kjo toka jonë...

Me hapin tënd,

çdo hap unë do ta mas,  
binjakja ime,

Republikë!

Dhe do të rendim ne kështu ndër mote:  
në sup një pushkë,

në dorë kazmë e libër,  
moj moshatarja ime,

Republikë!

1965



## FILIZA TË RINJ

Ej, vllaçko, e vure dhe ti bustinën,  
ushtari më i vogël i familjes sime,  
mbi sup hodhe çantën e shpinës  
si partizanët në të kuqet marshime.

Të puthi tetoja yllin e kuq,  
sa shumë i ngjake sot me djalin . . .  
Si ai hodhe pushkën në sup

dhe buzës të lulëzon gazi

Këtë rrugë ndjekim të gjithë bashkë:

dhe ti,

dhe unë,

dhe nipërit tanë.

Që qelli ynë mos ketë kurrë re,  
të gjithë këtu jemi ushtarë.

1968



## PO PSE?!

Një natë të bukur pranvere  
ai ma çfaqi haptas dashurinë.  
U tremba,

u skuqa,  
heshta unë . . .

Po pse?!

Kur unë e desha  
dhe më shumë ? !

1964



## KUR DESHA TË FLISJA ME TY

Receptorin ngrita . . .  
numrin e dashur formova,  
M'u duk atë çast se me emër të thirra,  
por shpejt nga ëndërra u zgjova.

Oh, s'është zëri yt ky!  
Unë me ngulm ty të kërkova  
por s'e dija se padashur  
numrin e telefonit ngatërrova.

1968

## TË DUA ...

Të dua, i dashur . . .  
Këtë dot s'ta fsheh,  
se ndjenjat stolira më janë.  
Lindin,

rriten,

dhe bëhen si det,  
kur nënë dashurinë ato kanë.

196

## SYTÈ E TU

Sa më pëlqejnë syt' e tu!  
Me dy yje ata më ngajnjë.  
Veç yjet janë shumë larg,  
kurse ata janë këtu,  
pranë.

1964



## TË TILLË GJITHMONË TË KAM ËNDËRRUAR

Të tillë gjithmonë të kam ëndërruar;  
të qeshur,

të çiltër,

si vetë rinia,

ndaj nuk çuditem në jam dashuruar.

E dija qysh kur . . .

Kjo ish dashuria!

T'i dua flokët pisë të zinj,  
atë shikim flakë e zjarr,  
dua gjithmonë të rri me ty:  
dhe kur je afër, dhe kur je larg.

**1966**



### TI KE BESIM...

Ti ke besim te dashuria ime,  
ndaj dhe s'më pyet: «A më dashuron?»  
Unë s'jam nga ato që japid prentime,  
që shpesh përsëritin: «Pa ty, nuk rroj dot!»

Dhe ne jemi dy lumenj dashurie  
që vinë e bashkohen në të njëjtin det.  
Ne jemi dy copa kaltërsie  
të një qielli të bukur,  
të një qielli pa re.

1966

## ATA DHE NE

Hart' e Europës...  
Me mozaikë shtetet ngjajnë...  
(Mes tyre m'e vogël ti, Shqipëri...)  
Nga ethet e kapitalit ata vuajnë  
të kuqen ngjyrë, të shëndetshmen ngjyrë,  
ty ta kanë zili.

1968

## ... KU KËMBËKRYQ U UL TRADHËTIA

Mbi dhëmbjen e popullit duke shkelur,  
ata prangat nënëshkruan . . .  
Qetësinë natës ja vodhën,  
Me zhurma tanksesh të blinduar.

Fuçiku botës sonte i flet,  
grushtet pas hekurash ka shtrënguar:  
«Njerëz, jini vigjilentë!»  
Tradhetia popujve shkon shaluar.

Sa të ftohtë solli kjo natë!  
Populli mardh,  
                                  po grushtin ngre.  
Tridhjet' e teta i qëndron pranë,  
bijt' e tij të vrarë i sheh.

Ndodhi kështu, ku tradhëtia  
këmbëkryq u ul me qeverinë;  
dhëmbët nguli te një traktat,  
me liri popujsh shuan urinë.

Nëndor 1968

## LËNDINA E LOTVE

Sa gota lotësh ke pirë,  
o lëndinkë, lëndinkë e lotve!  
Nisej këtu djalëri e vendit tim,  
kur jeta shpresat, si gur, i copëtonte.

Qëndron e heshtur ti përsëri,  
Veç gota lotësh më nuk hedh,  
se ka lulzuar kjo Shqipëri.  
Spirancën në tjetër det  
shqiptari kurrë s'do ta hedhë.


1966

## JAM BIJË E KËNGËS SË PAFUND

    Jam bijë e këngës së pafund.  
    Rrënjet e zemrës me të i mat.  
    Mes dallgësh,  
        tallazesh  
                ajo u përkund  
    dhe djep të qetë kurrë nuk pat.

    Ndaj nuk e dua dhe unë qetësinë,  
    më lodh vëtmia,  
        s'ka botë ajo!  
    Dua të përpjij stuhinë  
    dhe diellin mbi supe ta mbaj!

1966




## TRAKTET

Ju lindët mes krismave të pushkëve,  
në duart e Shqipërisë si flamurë,  
fletë të kuqe,

ku si metal' i shkrirë  
derdheshin shkëndijat,  
që s'do të shuheshin kurrë!

1968



#### 4 SHKURTI

Me pelerinën e saj  
kjo natë shkurti nxiu qiellin.  
Yjtë i fshehu në të sajën errësirë,  
yj të tjerë tokës i rrëmbeu,  
yj të rinj, që posa kishin lerë.

Por . . .

Nëna — tokë lotët shpejt i ndali,  
se yj të tjerë i ndrinin asaj.  
Këta, si shqipet, fole kishin malin,  
luftonin errësirën, zotrit e saj.

Më pelerinën të zezë s'e pati nata.  
Atë me gjak ja skuqi 4 Shkurti.  
Dhe ne e morëm,  
    e ndamë atë në fasha,  
si shenjë kujtimi  
nga nata e 4 Shkurtit.

1965




### TI JE MES NESH

Një ditë korriku re, Margaritë!  
Lulkuqet kurorë t'u bënë ty.  
U trembën armiqtë, kur sytë plot dritë  
vështrimin e tretën në horizont, diku.

A thua plumbat ëndërrimin ta prenë  
dhe dritën përjetë ta shuan ashtu?  
Jo, motër,  
në çdo hap që hedhim  
ti je mes nesh,  
këtu!

Ti je mes nesh, o motër Margaritë!  
Shikimi, buzëqeshja sa shumë na flet...  
Sa bukur këndoje dikur për lirinë  
dhe sot me ne  
buzëqesh,  
buzëqesh.

1968



## NJË LULE...

Dëshmorit  
**LLAZO JORGANXHI**

Ai donte këngën,  
pranverën me lule.

Donte . . .

e ç'nuk donte ai . . .  
Ndaj mbi varr të tij po hedh një lule  
që posa ma fali  
m'i ciltri frymëzim!

1966

## **NET PARTIZANE**

Përpin errësirën flak' e kuq' e zjarrit,  
Çeta partizane këngës seç ja merr.  
Është këng' e lirë, si shqipet e malit.  
Është këng' e bukur që freski të sjell.

I këndon lirisë, ëndërrve pa fund,  
që me fijet e saj e ardhmja qëndis,  
Er' e lirë e pyllit atë e përkund,  
er' e lirë e fushës në mal seç e nis.

Me tingujt e pastër të kësaj këngë,  
mes zjarrit e flakës këndove «Liri».  
Sa herë e ëndërrrove ditën e bardhë,  
aty, rreth zjarrit,  
o moj Shqipëri!...

**1966**

## DRITARE TË REJA TY TË HAP

Ti mbas tregimit tim harrohesh  
dhe shpesh më sheh me habi;  
për Lulin e vocër kur dëgjon  
vrenjtet balli yt dhe syt' e zinj.

Ti shpesh më thua:  
«Tregomë për partizanin,  
për diversantin, që si mi u kap!»  
Dhe unë, me gëzim, vogëlush i dashur,  
dritare të reja ty të hap.

1968

## NUK THINJEN ËNDERRAT

Sa shpejt kaluan vitet...

Dhe ballin ty ta rrudhi mendimi,  
vështrimin shpesh mbi të ardhmen trete  
aty ku puna s'dinte ç'ish pushimi.

Mbi flokët e zinj,  
telat e argjentë

mundohen të të thonë diçka,  
se iku koha, ku, si përrci i shpejtë  
rinia derdh gëzimin, gjithëçka.

Por ti mes punës gjen gjithmonë rininë,  
e vrullëshme të ka ardhur ajo sot.

Nuk ka gjë se flokët një ditë s'do të nxijnë,  
ëndrrat e tua ato s'i thinjin dot.

## NE ISHIM DY KRISMA TË SË NJËJTËS PUSHKË

### — Poemth —

Kur dhe natën s'rrinim dot të qetë,  
kur në të përgjonin mijëra sy,  
kur kjo tokë armët i kish ngjeshur,  
njohëm njëri—tjetrin ne të dy.

Së bashku thirrëm një ditë:  
«Duam bukë!»  
Dhe krah njëri-tjetrit ecëm gjithnjë.  
Ne ishim si krisma të së njëjtës pushkë,  
ndaj kurrë nga supi s'e hoqëm atë.

Sa net kaluam aty, afér zjarresh!  
Sa plagë duruam në trup që tē dy!  
Po zemrat mbetën gjithmonë batare  
dhe pushkën e patëm pérherë në sy.

Të dy ecëm marshimeve tē gjata  
dhe mbajtëm supeve breshër e shi.  
Prej nesh u step e trembur shtrëngata,  
se zjarr tē pashuar mbanim në gji.

Dhe kur bor' e bardhë gunën shtronnte  
dhe kur shiu binte me rrëmbim,  
dhe kur plagëve gjaku lumë shkonte  
ne vetëm thamë: «me ty gjithmon' do vij!»

I urrenim delikatet fjalë,  
lufta s'ish e lehtë pér ne aspak.  
Sa kështjella kishim pér tē marrë!  
Çdo pëllëmbë tokë fitohej me gjak.

S'deshëm që tē tjerët lirinë tē na dhuronin  
si plaçkë tē huaj nga tregu «botëror».  
Nga mali një ditë ky popull e zbriti  
me Partinë e tij . . . ISH NËNDOR!

\* \* \*

Dasma jonë,  
dasmë e çuditshme.  
Në të nuk pati nuse me duvak,  
mbi flokët e mi kapela ndriste  
me yllin e kuq, yllin partizan.

Në të nuk u derdh si lumë rakia.  
Kënga partizane, këngë dasme qe,  
ne, të dy, buzëqeshnim, ashtu, si fëmija  
kur shikon një qiel  
të pastër,  
pa re.

Kur agim' i kuq larg, në horizont,  
si flamin fitoresh ngrihej gjithmon' lart,  
partia gjithë i thirri në një tjetër front:  
ne së bashku dolëm të dy vullnetarë.

\* \* \*

U nisëm ne....  
Gropat e predhave të rrafshonim.  
U nisëm ne...  
Në arat grurë të mbillnim

dhe netëve librin duhej të shfletonim,  
se kish shumë gjëra që ende nuk i dinim.

Kështu kaloi rinia jonë, i dashur,  
në sup një pushkë,  
në dorë kazmë e libër.

... Përherë ne mbetëm krisma të një pushke,  
përherë bij të atdheut socialist,  
ne jemi udhëtarë të palodhur  
në rrugën për në komunizëm.

1968

## L É N D A

Kur linda unë .....	3
Moshatarëve .....	6
Në marshim .....	8
Rreshthohuni, motra .....	10
Ti .....	12
Ne dhe nata .....	13
Gjithmonë me ne .....	14
Në stërvitje .....	16
Net provimesh .....	17
Një shoqëje .....	18
Na prit me gaz, Myzeqe! .....	19
Është sinfonia jote, moj rini .....	20
Sonte .....	21
Letër vëllait .....	22
Rrugica ime .....	24
Moshatares Republikë .....	25
Filiza të rinj .....	26
Po pse?! .....	28
Kur desha të flisja me ty .....	29
Të dua .....	30
Sytë e tu .....	31
Të tillë gjithmonë të kam ëndërruar .....	32
Ti ke besim .....	34
Ata dhe ne .....	35
Ku këmbëkryq u ul tradhëtia .....	36
Lëndina e lotëve .....	38
Jam bijë e këngës së pafund .....	39
Traktet .....	40
4 shkurti .....	41
Ti je mes nesh .....	43
Një lule .....	44
Net partizane .....	45
Dritare të reja ty të hap .....	46
Nuk thinjen ëndërrat .....	47
Ne ishim dy krisma të s'mjëjtës pushkë .....	48

**GRADUAR SHTETI**

51248